REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit 01B
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No: 1882
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages 2
Data: Datum: Date: 08/06/2015
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria – Vlada - Government***

***Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology***

KabinetiiMinistrit/KabinetMinistra/Cabinet of the Minister

---

Datë: 5 qershor 2015
Ref: 215/01B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, të nenit 5 (5) të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ 10/2008 për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave dhe në bazë të kërkesës së DKA-së në Gjilan datë. 14.05.2015, me nr. 05.061-45376, nxjerr:

## VENDIM

1. Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Abaz Ajeti" në Gjilan, riemërtohet si Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët " 7 Marsi".

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij .

## Arsyetim

Duke u mbeshtetur ne dispozitat e më lartëshënuara dhe në kërkesën e DKA-së në Gjilan, nr. 05.061-45376, të datë 14.05.2015, kërkesën e Këshillit të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët në Gjilan nr.147/2015 dt. 07.05.2015, Komisioni për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MAShT në mbledhjen e mbajtur më 25.05.2015, shqyrtoi kërkesat e tyre për ndërrimin e emrit të kësaj shkolle nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Abaz Ajeti" në Shkolla fillore dhe e Mesme e Ulët "7 Marsi". Komisioni konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt, ngase Këshilli i Shkollës ka dhënë tre propozime dhe për secilin propozim ka dhënë arsyetimin me shkrim, duke i dhënë prioritet emrit "7 Marsi". Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan ka përkrahur propozimet dhe ka rekomanduar propozimin e bërë nga Këshilli i Shkollës të cilin e ka arsyetuar me shkrim në kërkesën e sjellë në MAShT. Prandaj, Komisioni i MASHT-it miratoi propozimin që kjo shkollë të mbajë emrin "7 Marsi".

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe në këto argumente, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtresa në MAShT.

Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**Vendimi ju dorëzohet:**
1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan;
2. Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Abaz Ajeti" në Gjilan;
3. Komisionit për Emërtime dhe Riemërtime të Shkollave në MASHT;
4. Arkivit në MAShT.